



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.52**

**9 maj**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe	
Vendim i GJK nr.16, datë 27.4.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.154/2, datë 31.3.2004 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.15, datë 29.6.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën.....	1379
Vendim i GJK nr.17, datë 30.4.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.539, datë 3.2.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë .....	1383
Vendim i GJK nr.18, datë 3.5.2007	Me objekt shpalljen e vendimit nr.4, datë 1.7.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën.....	1386
Vendim i GJK nr.19, datë 3.5.2007	Me objekt shfuqizimin e nenit 1 pika 1; e nenit 4; e nenit 7 pika 2; e nenit 9; e nenit 10 pikat 1, 2, përsa përfshijnë edhe institucionet e pavarura kushtetuese; si dhe të nenit 20 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë .....	1389

Vendim i GJK  
nr.20, datë 4.5.2007

Me objekt: 1. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt (jo më pak se një e katërta e deputetëve), duke shpallur si antikushtetues:

a) vendimin nr.60, datë 27.9.2006 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e objektit të kërkesës së 35 deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e lidhjeve nepotike, konfliktin e interesit dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin prej tyre për Kryeministrin, familjarët dhe të afërmit e tij”;

b) vendimin nr.59, datë 18.9.2006 “Për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike”.

2. Shfuqizimin e vendimit nr.59, datë 18.9.2006 të Kuvendit të Shqipërisë “Për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike”, si antikushtetues.....

**VENDIM**  
**Nr.16, datë 27.4.2007**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datën 15.12.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.49/19 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** ANILA CAPO, përfaqësuar nga avokatët Fatmir Braka e Artan Hajdari, me prokurë.

**SUBJEKT I INTERESUAR:** KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, përfaqësuar nga Mine Progonati e Selim Kryeziu, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.154/2, datë 31.03.2004 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.15, datë 29.6.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 44, 131/f, 135 e 147 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesja pretendon se organet që kanë shqyrtuar çështjen e saj i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe parashtron këto pretendime kryesore:

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë argumentuar shkakun e shkarkimit të saj nga detyra sipas nenit 147/6 të Kushtetutës, pasi praktikisht një shkak i tillë nuk ekziston. Këto organe nuk kanë argumentuar rëndësinë e shkeljeve të kryera dhe pasojave të ardhura dhe kanë vlerësuar masën e dhënë vetëm mbi bazën e normave të Kodit të Etikës së Gjyqtarit.

- Nuk ka lidhje midis veprimeve e sjelljeve të kërkueses në gjykim dhe jashtë tij dhe blerjes së pronës nga shoqëria tregtare ku është ortak bashkëshorti i saj. Blerja është realizuar mbi bazën e një ankandi të shpallur nga pronarët dhe bazuar në ofertën më të shtrenjtë, në kushtet e një pjesëmarrjeje të gjerë subjektsh konkurruese.

- Pengesa ligjore për blerje të pasurive nga gjyqtarët, parashikuar nga neni 709 i Kodit Civil, shtrihet vetëm për periudhën kur gjyqtari ka në shqyrtim një konflikt të lidhur me atë pasuri. Në çështjen në shqyrtim, në momentin e shitjes së truallit nuk ekzistonte ndonjë konflikt gjyqësor në shqyrtim nga kërkuesja si gjyqtare.

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka dalë jashtë kompetencave të tij, sepse në shqyrtimin e çështjes konkrete ka prekur pavarësinë e gjyqtarit, paprekshmërinë e palëvizshmërinë e gjyqtarit, sepse ka bërë vlerësim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe ka larguar nga detyra gjyqtaren për interpretim e zbatim të gabuar të ligjit.

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Gjykata e Lartë kanë shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë dhe paanshmërinë në gjykim.

Përfaqësuesit e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke kundërshtuar pretendimet e kërkueses, parashtruan:

- Objekt shqyrtimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka qenë sjellja e gjyqtarës gjatë ushtrimit të detyrës dhe ndikimet e jashtme mbi vendimmarrjen e saj. Këto organe kanë konkluduar se veprimet vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, cenojnë autoritetin e pushtetit gjyqësor, janë në kundërshtim me detyrën e gjyqtarës dhe, si të tilla, përbëjnë akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e gjyqtarit.

- Shkeljet e kryera nga kërkuesja janë shkelje të etikës, pasi bashkëshorti i saj ka blerë pronën në konflikt gjyqësor. Ajo, padrejtësisht nuk ka hequr dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, me të cilën ka pasur arsye të forta njëanshmërie, sepse gjatë procedimit disiplinor, ka pranuar se kishte dijeni lidhur me interesin e bashkëshortit për blerjen e pronës në konflikt gjyqësor që gjatë gjykimit të çështjes.

- Kërkuesja ka interesa direkt ekonomike mbi pronën e blerë, pasi sipas regjimeve pasurore bashkëshortore ligjore, përfiton 50 % të të drejtave nga ajo pasuri.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vjollca Meçaj, përfaqësuesit e kërkueses që u shprehën për pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjektit të interesuar, që u shprehën për rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

#### VËREN:

Me vendimin nr.154/2, datë 31.3.2004 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kërkuesja Anila Capo është larguar nga detyra me motivacionin se ka kryer veprime në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës si gjyqtare. Kundër këtij vendimi ajo ka parashtruar ankesë pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat, me vendimin nr.15, datë 29.06.2004, kanë vendosur mospranimin e kërkesës.

Kërkuesja pretendon se procesi i kryer për procedimin e saj disiplinor nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si dhe ai i shqyrtimit të ankesës nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor. Këtë pretendim ajo e argumenton me faktin se e kanë larguar nga detyra për shkaqe që nuk parashikohen në nenin 147/6 të Kushtetutës; se organet që kanë shqyrtuar çështjen kanë bërë vlerësime të vendimeve gjyqësore të formës së prerë që ajo ka dhënë si gjyqtare; kanë gjykuar mbi mënyrën e zbatimit të ligjit prej saj gjatë ushtrimit të funksionit, e për pasojë kanë cenuar pavarësinë e gjyqtarit dhe të pushtetit gjyqësor në dhënien e drejtësisë.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se për shqyrtimin e çështjes ka rëndësi të veçantë përmbajtja e nenit 147 pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe praktika gjyqësore e krijuar prej kësaj Gjykate në çështje analoge. Dispozita e sipërcituar ka parashikuar standarde, të cilat garantojnë patundshmërinë e gjyqtarit. Ajo sanksionon se gjyqtari mund të largohet nga detyra vetëm kur vërtetohet një nga rastet e parashikuara shprehimisht në Kushtetutë.<sup>1</sup> Patundshmëria e gjyqtarit nuk përfaqëson një privilegj dhe as nuk nënkupton se kjo kategori nëpunësish shtetërorë janë të pakontrollueshëm. Kufizimi i shkaqeve të largimit të tyre nga detyra dhe parashikimi i tyre drejtpërdrejt nga Kushtetuta ka për qëllim të ndikojë, së bashku me faktorë të tjerë, në realizimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, me qëllim mundësimin e ushtrimit prej tij të funksioneve të veta për dhënien e drejtësisë, pa ndërhyrje nga jashtë. Lidhur me sa më sipër, kjo Gjykatë është shprehur se paprekshmëria dhe palëvizshmëria e gjyqtarit janë elemente thelbësore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke theksuar në mënyrë të veçantë se<sup>2</sup>: *“Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke i dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë e në zbatim të Kushtetutës”*.

<sup>1</sup> Neni 147, pika 6 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *“Gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale ...”*.

<sup>2</sup> Vendimi nr.3, datë 20.2.2006 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Nga materialet e çështjes rezulton se kërkueses i atribuohen shkelje që, sipas Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës e që janë të papajtueshme me funksionet e gjyqtarit, si dhe në kundërshtim me moralin shoqëror. Për këtë qëllim, në vendimin përkatës janë evidentuar një seri faktesh që kanë për qëllim të argumentojnë shkeljen e disiplinës në punë nga ana e kërkueses dhe konkretisht, të neneve 34, 41, pikat 1, 6 e 7, të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Mbi këtë argumentim mbështetet edhe pjesa urdhëruese e vendimit, ku përfundimisht përcaktohet dhënia ndaj kërkueses e masës disiplinore “largim nga detyra”, me motivacionin e kryerjes së veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës.

Në pjesën arsyetuese të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, objekt shqyrtimi, ekziston edhe një referim në dispozitat kushtetuese, në të cilin thuhet konkretisht se: “*Gjithashtu, ajo sjellje dhe veprimtari e gjyqtarës Anila Capo, përbëjnë sjellje që diskrediton rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 147 pika 6*”. Gjatë gjykimit, përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, e përdorën këtë referim si argument për të rrëzuar pretendimet e kërkueses. Lidhur me këtë çështje, jurisprudenca e krijuar nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese<sup>1</sup> ka theksuar se aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit janë elemente kushtetuese të domosdoshme për rastet e ndëshkimit me largim nga detyra të gjyqtarit. Kështu është e nevojshme një analizë e hollësishme rreth këtyre elementeve nga organi që procedon disiplinarisht gjyqtarin, i cili, rast pas rasti, vlerëson ekzistencën e tyre. Është nënvizuar se është detyrë e organit procedues të vlerësojë e analizojë shkallën e rëndësisë së diskreditimit të pozitës dhe figurës së gjyqtarit, sepse dispozita kushtetuese pranon si shkak për largimin e gjyqtarit nga detyra vetëm diskreditimin “*e rëndë*” të pozitës dhe figurës.

Në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese vëren se vetëm referimi në dispozitën kushtetuese nuk është i mjaftueshëm për të treguar dhe argumentuar lidhjen midis shkeljeve të disiplinës të kryera nga kërkuesja dhe shkakut të rëndë të kërkuar nga Kushtetuta për largimin nga detyra.

Nga materialet e çështjes rezultoi se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë shqyrtuar ankimin e kërkueses ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dhe përfundimisht kanë vendosur mospranimin e kërkesës. Gjykata Kushtetuese vëren se edhe ky organ nuk ka mbajtur parasysh përcaktimin kushtetues për largimin nga detyra të gjyqtarit. Ashtu sikundër Këshilli i Lartë i Drejtësisë, edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë justifikojnë masën disiplinore të dhënë vetëm me shkeljet e disiplinës në punë, pa argumentuar se si këto shkelje kanë passjellë diskreditimin e rëndë të pozitës dhe figurës së gjyqtarit.

Gjykata Kushtetuese çmon se sa më sipër, është e mjaftueshme për të vlerësuar se kërkueses i është shkelur e drejta për proces të rregullt ligjor nga të dyja organet proceduese, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Pretendimet e tjera të kërkueses, që lidhen me paligjshmërinë e kontrollit mbi vendimmarrjen gjyqësore dhe të drejtën e saj si gjyqtare për të zbatuar ligjin në çështjet që ka pasur në shqyrtim, nuk qëndrojnë. Gjatë gjykimit kushtetues rezultoi se vendimmarrja e kërkueses ishte marrë në shqyrtim nga organet e procedimit disiplinor jo me qëllim për t’u shprehur lidhur me bazueshmërinë e vendimeve të dhëna, por vetëm në funksion të analizës së sjelljes së kërkueses gjatë procesit të gjykimit dhe jashtë tij. Zgjidhja juridike, që kërkuesja u ka dhënë çështjeve gjyqësore në ngarkim, rezulton të ketë ndjekur rrugën normale ligjore, pa pasur ndonjë ndërhyrje nga organe të tjera jashtë sistemit gjyqësor. Gjykata Kushtetuese konkludon se edhe pretendimet për shkeljen e parimit të paanësisë dhe prezumimin e pafajësisë, gjatë procedimit të ndëshkimit disiplinor nuk qëndrojnë, ndërsa pretendimet e tjera nuk lidhen me procesin e rregullt ligjor, prandaj kjo Gjykatë nuk i merr në konsideratë.

Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, janë rezultat i procesit të parregullt ligjor dhe për pasojë, vijnë ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

---

<sup>1</sup> Vendimi nr.17, datë 12.11.2004 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.154/2, datë 31.3.2004 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.15, datë 29.6.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

### MENDIMI I PAKICËS

Kemi mendim të kundërt me shumicën, që ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Sikundër rezulton nga vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ish-gjyqtarja Anila Capo është shkarkuar nga detyra e gjyqtarës me motivacionin për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, si dhe për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Mbi ankimin e saj, çështja është shqyrtuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që me vendimin nr.15, datë 29.6.2004 kanë vendosur mospranimin e ankesës dhe lënien në fuqi të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kolegjet e Bashkuara kanë konkluduar se ankuesja është shkarkuar nga detyra pasi ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit, si dhe ka kryer veprime që diskreditojnë figurën e gjyqtarit.

Motivacioni i shkarkimit nga detyra që përmendet në të dyja vendimet e mësipërme është mbështetur në nenin 147 pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet: “Gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ... për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ...”, si dhe nenin 41 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Shkeljet e ligjit, si dhe veprimet apo sjelljet që kanë shërbyer si shkak për shkarkimin nga detyra të ish-gjyqtarës Anila Capo janë pasqyruar në përmbajtjen e dy vendimeve.

Kërkuesja, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ashtu edhe gjatë seancës së zhvilluar në këtë Gjykatë, bazuar në nenin 131 shkronja “f” të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, ka ngritur pretendimin se ndaj saj Këshilli i Lartë i Drejtësisë edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor. Sipas kërkueses, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vepruar jashtë kompetencave të tij duke rivlerësuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, ç’ka përbën ndërhyrje në dhënien e drejtësisë.

Kërkuesja shprehet se vendimet e saj në gjykimin e çështjes civile me palë ndërgjyqëse Ministria e Arsimit dhe Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk vijnë në kundërshtim me ligjin procedural, këto vendime lidhur me veprimtarinë jashtëgjyqësore nuk kompromentojnë figurën e gjyqtarit nisur nga fakti se prona, objekt i këtij gjykimi, u ble nga bashkëshorti i kërkueses, pas dhënies së vendimit gjyqësor.

Në lidhje me këto pretendime të kërkueses është rasti të përmendet se Këshilli i Lartë i Drejtësisë është organi i ngarkuar nga Kushtetuta si për emërimin, ashtu edhe për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve, duke përcaktuar dhe motivacionin përkatës për këtë masë, sikundër ka vepruar edhe në rastin konkret. Ai ka analizuar veprimet e kryera nga kërkuesja dhe si organ i ngarkuar nga Kushtetuta për disiplinimin e gjyqësorit dhe ruajtjen e figurës së gjyqtarit ka arritur në përfundimin se blerja e pronës që më parë ka qenë objekt gjykimi nga ajo gjyqtare vjen në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe diskrediton rëndë figurën e gjyqtarit. Në të njëjtën kohë, si

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ashtu edhe Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të kësaj çështje nuk kanë cenuar parimin e mosndërhyrjes në dhënien e drejtësisë dhe as atë të fuqisë detyruese të vendimeve të formës së prerë, sepse ato nuk kanë bërë vlerësimin e vendimeve gjyqësore të dhëna për këtë çështje, por kanë konstatuar se këto vendime janë shoqëruar më pas me akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit dhe që cenojnë prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese në mjaft vendime të saj ka bërë të qartë dallimin esencial midis kontrollit kushtetues që ajo ushtron dhe kompetencave të Këshillit të Lartë të Drejtësisë e Gjykatës së Lartë në lidhje me gjykimin e këtyre kategori çështjesh. Duke u përqendruar kontrolli i saj vetëm në procesin e rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se nuk është në kompetencën e saj të vlerësojë nëse faktet dhe shkeljet e pranura në vendime ekzistojnë, nëse ato janë të vërteta dhe nëse ato përbëjnë shkak për masën disiplinore. Vlerësimi i veprimeve, vërtetësia e tyre, pasojat e ardhura dhe masa disiplinore e marrë ndaj gjyqtarit janë në kompetencën e organeve të caktuara për marrjen e masës sikundër është Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Gjykata e Lartë që kontrollon ligjshmërinë e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Gjithçka u theksua lidhur me këtë dallim, midis kompetencave të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatës së Lartë nga njëra anë dhe Gjykatës Kushtetuese nga ana tjetër, gjejnë konkretizim në vendimet nr.18, datë 18.4.2000; nr.11, datë 27.5.2004 dhe nr.12, datë 17.6.2004 të Gjykatës Kushtetuese. Duke e parë çështjen në këtë këndvështrim, vendimi i shumicës nuk i përmbahet praktikës dhe orientimeve të Gjykatës Kushtetuese, sepse në rastin e kërkesës së paraqitur për shqyrtim nuk parashtrohen probleme që lidhen me procesin e rregullt ligjor, por probleme që u përkasin për diskutim e zgjidhje organeve të tjera.

Për këto arsye, duke e konsideruar vendimin e shumicës si një ndërhyrje në kompetencat e organeve të tjera, kemi mendimin se kërkesa e kërkueses duhet rrëzuar.

Kryetar: Gj. Sauli  
Anëtar K. Puto

**VENDIM**  
**Nr.17, datë 30.4.2007**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datat 31.10.2006 dhe 4.12.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.34/4 Akti, që i përket:

KËRKUES: VERI SATKA, përfaqësuar nga avokatët Vasil Plaku e Viktor Konomi, me prokurë.

#### SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KËSHILLI I QARKUT BERAT, përfaqësuar nga Olta Gace, me autorizim,
2. ZYRA E GJENDJES CIVILE SKRAPAR,
3. XHEVIT SATKA, përfaqësuar nga avokat Adnor Shameti, me deklaram,
4. SYTKI MUÇA, përfaqësohet nga djali i tij, Ajet Muça, me prokurë,
5. KUJTIM MUÇA,
6. GËZIM GURI,
7. NAXHIJE OZYER, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.539, datë 3.2.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi, duke pretenduar se vendimi i lartpërmendur është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor në kuptimin kushtetues, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e tij:

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka bërë vlerësim provash duke marrë kompetenca që i takojnë gjykatës së rrethit gjyqësor dhe gjykatës së apelit.

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka vënë në pozicion të pafavorshëm si palë, sepse nuk i krijoi mundësi të barabarta me palën tjetër për të organizuar mbrojtjen. Për natyrën e gjykimit në këtë shkallë, ai ka qenë i përgatitur vetëm për debat gjyqësor për pretendimet ligjore e jo për debat për provat.

- Është shkelur parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme, sepse relatori i çështjes ishte relator edhe në gjykimin e mëparshëm dhe kishte dhënë mendim duke bërë vlerësim provash e duke shprehur pikëpamjet e veta për problemet ligjore.

- Gjykata e Lartë i ka mohuar pa të drejtë legjitimitimin aktiv për vërtetimin e qenies së marrëdhënies juridike të birësimit në favor të tij dhe mosqenies së birësimit në favor të subjektit të interesuar, Xhavit Satka.

#### GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuessit, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

#### VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Skrapar, me vendimin nr.106, datë 8.4.2003, ka vendosur pranimin tërësisht të padisë së kërkuessit Veri Satka dhe pranimin pjesërisht të padisë së subjekteve të interesuara Sytki Muça, Kujtim Muça e Gëzim Guri, ngritur kundër subjekteve të tjera të interesuara: Këshillit të Qarkut Berat, Zyrës së Gjendjes Civile Skrapar, Xhevit Satka e Naxhije Ozyer. Gjykata ka njohur si të pavërtetë vendimin nr.116, datë 20.10.1964 të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit Skrapar për birësimin e dy të miturve duke e goditur atë si të falsifikuar; ka njohur faktin juridik se vetëm kërkuesi është birësuar nga bashkëshortët Jahja e Xhevrie Satka me vendimin nr.116, datë 20.10.1964; ka përjashtuar subjektin e interesuar Xhevit Satka nga trashëgimtar i radhës së parë të trashëgimlënësve Jahja e Xhevrie Satka dhe ka rrëzuar gjithashtu kërkimet e tjera të personave të tretë Sytki Muça, Kujtim Muça e Gëzim Guri.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.98, datë 9.7.2003, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.539, datë 3.2.2005, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor e të gjykatës së apelit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuessit e të subjekteve të interesuara, Sytki Muça, Kujtim Muça e Gëzim Guri, me arsyetimin se kërkuesi nuk arriti të provojë që akti është i falsifikuar dhe se gjykatat e të dy shkallëve nuk i janë referuar dispozitave përkatëse të kohës.

Kërkuesi ka ngritur disa pretendime për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, por në çështjen në shqyrtim Gjykata Kushtetuese do të përqendrohet tek ato pretendime që kanë të bëjnë me cenimin e parimeve kushtetuese që e bëjnë procesin të parregullt

në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës e të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë këndvështrim ka rëndësi të analizohen pretendimet për cenimin e parimeve të barazisë së armëve dhe të paanësisë, si garanci për një “grykim të drejtë” dhe që mundëson krijimin e besimit që gjykatat duhet të gëzojnë në një shoqëri demokratike.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Skrapar dhe Gjykata e Apelit Vlorë, pas administrimit e vlerësimit të provave në grykimet e zhvilluara në prani të palëve dhe duke zbatuar parimet e kontradiktoritetit në grykim e të mundësive të barabarta të palëve për të bërë mbrojtjen në seancë gjyqësore, kanë njohur si të pavërtetë vendimin nr.116, datë 20.10.1964 të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit Skrapar dhe si të vërtetë faktin juridik të birësimit vetëm të kërkuesit nga bashkëshortët Jahja e Xhevrie Satka.

Në të kundërt të vlerësimit që kanë bërë gjykatat e të dy shkallëve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se kërkuesi nuk provoi që vendimi nr.116, datë 10.10.1964 i Komitetit Ekzekutiv të jetë i falsifikuar. Në këtë përfundim kolegji ka arritur duke analizuar provat, e sidomos aktin e ekspertimit, dhe duke arsyetuar ndër të tjera se nga këqyrja e këtij akti nuk rezulton që vendimi i lartpërmendur i Komitetit Ekzekutiv të jetë i falsifikuar.

Gjykata Kushtetuese vëren se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e barazisë së armëve përsa i përket mundësive të barabarta të palëve për të organizuar mbrojtjen në grykimin në atë kolegji.

Nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e grykimit në Gjykatën e Lartë. Sipas nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ky kolegji ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin e ligjit ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, por nuk mund të bëjë një rivlerësim të provave, në të kundërt me atë që kanë bërë gjykatat e hallkave më të ulëta dhe mbi këtë bazë të vendosë rrëzimin e kërkesëpadisë. Në çështjen në shqyrtim jo vetëm është bërë një rivlerësim i tillë duke u shtrembëruar në ndonjë rast edhe realiteti i fakteve, por për më tepër, ky rivlerësim është bërë duke ndërhyrë në kompetencën që kishin gjykatat e faktit për të nxjerrë konkluzione juridike mbi bazën e mendimeve të ekspertëve për rregullshmërinë e vendimit të Komitetit Ekzekutiv dhe të regjistrimit të birësimeve në dokumentet e gjendjes civile, të marra këto në lidhje me gjithë provat e tjera.

Duke i hyrë problemit të rivlerësimit të provave në një kohë kur kërkuesi, ashtu siç pretendon edhe vetë, nuk ishte i përgatitur për të paraqitur argumentet e veta lidhur me këtë rivlerësim të tyre dhe kur edhe vetë jurisprudenca e asaj gjykate nuk e ka pranuar shqyrtimin e provave nga kolegjet, Gjykata e Lartë i ka vënë palët në pozita të pabarabarta në grykim.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka lejuar gjithashtu shkelje të parimeve kushtetuese e procedurale për një grykim të drejtë e të paanshëm.

“Paanshmëria konsiderohet një parim i rëndësishëm, që garanton rendin e së drejtës dhe mundëson krijimin e besimit që gjykatat duhet të gëzojnë në një shoqëri demokratike”.<sup>1</sup>

Ky parim përmban në vetvete elementin subjektiv që ka të bëjë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në grykim në rrethanat e ndërhyrjeve e presionit dhe me elementin objektiv që ka të bëjë me dhënien e garancive të nevojshme për një grykim të paanshëm nga vetë gjykata, për të përjashtuar çdo dyshim të përligjur në këtë drejtim.

Ndryshe nga ç’ka parashtruam më lart, në çështjen objekt shqyrtimi nuk është garantuar rendi i së drejtës dhe nuk i janë dhënë kërkuesit garancitë e nevojshme objektive për të krijuar besim në paanësinë e gjykatës. Në rigrykimin e çështjes në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë si relator i njëjti gjyqtar që ka marrë pjesë si i tillë edhe në grykimin e mëparshëm në atë kolegji. Në vendimin nr.1055, datë 3.11.1999 të atij kolegji është vendosur prishja e vendimeve të gjykatës së rrethit e të apelit, me të cilët ishte pranuar padia e kërkuesit dhe është dërguar çështja për rigrykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Skrapar. Në këtë vendim është arsyetuar, ndërmjet të tjerave, për problemet e themelit të çështjes që kishin të bënin me zbatimin e ligjit të kohës së lindjes së marrëdhënies juridike apo të kohës së grykimit të çështjes, me interpretimin e përmbajtjes së këtyre normave, me juridiksionin e gjykatës për shqyrtimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ të

<sup>1</sup> Vendimi “Pullaqs kundër Britanisë së Madhe”, datë 10.6.1996, RJD 1996 - III

birësimit etj. Këto probleme janë diskutuar përsëri në rigjykimin e çështjes në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

Vlerësimi për respektimin e parimit të paanësisë bëhet, sipas rastit konkret, duke marrë në konsideratë elementet subjektive dhe objektive të gjykimin.

Në vendimin nr.16, datë 25.4.2003, Gjykata Kushtetuese nuk ka pranuar cenimin e parimit të paanësisë në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, në rastin kur gjyqtari që ka marrë pjesë në trupin gjykues që prishi vendimin e gjykatës së apelit e ktheu çështjen për rigjykim, ka marrë pjesë në dhomën e këshillimit, ku u vendos mospranimi i rekursit. Moscenimi i parimit të paanësisë është arsyetuar me faktin se, në dhomën e këshillimit, nuk gjykohet çështja në themel, por trajtohet vetëm prania ose jo e shkaqeve të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

Në rastin në shqyrtim, çështja jo vetëm është shqyrtuar në dyja rastet në seancë gjyqësore me të njëjtin relator, por janë trajtuar të njëjtat probleme të themelit të çështjes. Kjo krijoi shqetësimin e kërkuesit për mungesën e garancive të mjaftueshme për paanësinë e gjykatës, aq më tepër që vendimi është marrë me shumicë të thjeshtë votash. Prandaj, heqja dorë e relatorit nga gjykimi ishte e domosdoshme si për interesin e drejtësisë, ashtu edhe të palëve në gjykim

Përsa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe si i tillë, ai duhet shfuqizuar si i papajtueshëm me Kushtetutën.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.539, datë 3.2.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### VENDIM

**Nr.18, datë 3.5.2007**

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Pllaçi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 30.11.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.42/12 Akti që i përket:

**KËRKUES:** SELAMI ZALLI, përfaqësuar nga avokat Vangjel Kosta, me deklaram.

**SUBJEKT I INTERESUAR:** PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shpallja si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.4, datë 1.7.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar se vendimi i kundërshtuar është rezultat i një procesi të parregullt ligjor në drejtimit e mëposhtme:

- Është cenuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, sepse gjykatat nuk janë shprehur për të gjitha kërkimet e paraqitura.

- Çështja nuk është gjykuar nga një "gjykatë e caktuar me ligj", sepse Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë dalë me vendim unifikues. Për pasojë, Kolegjet e Bashkuara nuk ishin kompetente ta shqyrtonin vetë çështjen, por duhet t'ia dërgonin për shqyrtim Kolegjit Civil të asaj Gjykate.

- Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë mbajtur qëndrim të njëanshëm, sepse vendimi i kundërshtuar vjen në kundërshtim me një vendim të mëparshëm unifikues të kësaj Gjykate.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesin e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

#### VËREN:

Me dekretin nr.3037, datë 1.6.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, kërkuesi është transferuar nga detyra e prokurorit të Drejtorisë së Hetimit e Kontrollit të Prokurorisë së Përgjithshme, në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Mbi padinë e kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.97, datë 18.9.2002, ka vendosur pranimin e padisë, duke shfuqizuar dekretin nr.3037, datë 1.6.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë përsa i përket transferimit të kërkuesit.

Mbi rekursin e Prokurorit të Përgjithshëm, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.3, datë 30.1.2002, kanë vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Mbi kërkesën e Selami Zallit, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.38, datë 23.12.2003, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim po në atë Gjykatë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.4, datë 1.7.2004, kanë vendosur ndryshimin e vendimit nr.97, datë 18.9.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë.

Vendimi i fundit i Kolegjeve të Bashkuara është kundërshtuar nga kërkuesi duke kërkuar shfuqizimin e tij si jokushtetues.

##### *1. Për shkeljen e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës.*

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara është kundërshtuar nga kërkuesi me pretendimin se kjo Gjykatë nuk është shprehur për të gjitha kërkimet e tij, për pasojë është shkelur e drejta e aksesit në gjykatë, si një nga aspektet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Konkretisht, kërkuesi ka pretenduar se me padinë drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, përveç kërkimit për shfuqizimin e dekretit nr.3037, datë 1.6.2001 të Presidentit të Republikës për transferimin e tij ka kërkuar edhe "detyrimin për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga nxjerrja aktit".

Lidhur me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese konstatoi se në datë 29.3.2002 kërkuesi ka ngritur padi me objekt shfuqizimin e dekretit të mësipërm të Presidentit të Republikës. Në këtë padi nuk është parashtruar ndonjë kërkim tjetër nga ana e kërkuesit për dëmshpërblim. Më pas, kërkuesi ka kërkuar shtimin e objektit të padisë për detyrimin e të paditurve për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga transferimi i paligjshëm. Rezulton gjithashtu se në këtë kërkesë, nga ana e kërkuesit, nuk është përcaktuar vlera e objektit të padisë. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur shfuqizimin e dekretit, ndërsa për kërkimin për shpërblimin e dëmit nuk është shprehur.

Në Gjykatën e Lartë çështja ka shkuar mbi bazën e rekursit të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe të vendimit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara. Lidhur me këtë kërkim të kërkuarit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur se kjo Gjykatë nuk mund të shprehet për “*zgjidhjen e pasojave që rrjedhin prej transferimit*”, sepse “*nuk janë trajtuar gjatë gjykimit në apel*” dhe se “*këto kërtime mund të zgjidhen në një gjykim tjetër në bazë të disponibilitetit të paditësit*”.

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese përsërit qëndrimin e saj se e drejta për t’u drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës. Por, Gjykata Kushtetuese thekson se e drejta e aksesit në gjykatë nuk është absolute, pasi nga natyra e saj kjo e drejtë kërkon rregullim ligjor. Një aspekt konkret i këtij rregullimi janë edhe rregullat për paraqitjen e padisë, që përcakton Kodi i Procedurës Civile. Për pasojë, fakti se kërkuari ka paraqitur një kërkesë për shtimin e objektit të padisë, që nuk përmbush standardet e padisë nuk e vinte gjykatën para detyrimit për ta marrë atë në shqyrtim. E drejta e aksesit në gjykatë imponon për kërkuarin respektimin e rregullave procedurale në këtë drejtim. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese konstaton se Gjykata e Lartë e ka lënë të hapur mundësinë që kërkuari lidhur me kërkimin për shpërbllimin e dëmit mund t’i drejtohet me padi të veçantë gjykatës së apelit.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese konkludon se e drejta e aksesit në gjykatë nuk është shkelur.

### 2. Për shkeljen e parimit të gjykimit nga një “gjykatë e caktuar me ligj”.

Gjykata vë në dukje se objekti i termit “*gjykatë e caktuar me ligj*”, në nenin 42/2 të Kushtetutës, është të sigurojë që organizimi gjyqësor në një shoqëri demokratike të mos varet në diskrecionin e ekzekutivit, por të rregullohet me ligj të parlamentit. Gjykata shton se shprehja “*gjykatë e caktuar me ligj*” mbulon jo vetëm bazën ligjore për ekzistencën e vetë “*gjykatës*”, por edhe përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për gjykimin e çdo çështjeje konkrete.

Në këndvështrimin e konsideratave të mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për gjykimin e çështjes që u është paraqitur kanë qenë “*gjykatë e caktuar me ligj*”.

Sipas nenit 481 të Kodit të Procedurës Civile “*Kryetari i Gjykatës së Lartë mund të vendosë që gjykata të shprehet në kolegje të bashkuara për rekurse të paraqitura nga palët, për të cilat ka praktika të ndryshme e të mëparshme në kolegjet e thjeshta*”. Ndërsa sipas nenit 485 të këtij Kodi, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, si kolegji civil, ashtu dhe Kolegjet e Bashkuara kanë të njëjtat mundësi procedurale për të vendosur. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se shqyrtimi i çështjes në këto kolegje nuk e keqëson mundësinë procedurale të kërkuarit.

Përsa sipër, Gjykata Kushtetuese konkludon se në rastin në shqyrtim ka një bazë të vlefshme juridike që çështja e kërkuarit të shqyrtohet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë si “*gjykatë e caktuar me ligj*”.

### 3. Për shkeljen e parimit të gjykimit nga një “gjykatë e paanshme”.

Përsa i përket “*paanshmërisë*” në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, ekzistojnë dy teste për të vlerësuar nëse një gjykatë është e paanshme: i pari konsiston në përcaktimin e bindjes personale të gjyqtarit në fjalë, në një çështje të dhënë; dhe i dyti, në vlerësimin nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në këtë drejtim. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor.

Në çështjen në shqyrtim, kërkuari ka parashtruar si rrethanë për njëanshmërinë e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë pretendimin se vendimi i dhënë nga kolegjet e bashkuara vjen në kundërshtim me një vendim të mëparshëm unifikues të këtyre kolegjeve.

Nisur nga konsideratat e mësipërme, Gjykata Kushtetuese konkludon se ky pretendim nuk ka të bëjë me njëanshmërinë e gjykatës. Zbatimi i ligjit dhe unifikimi i praktikës gjyqësore është në diskrecionin e Gjykatës së Lartë. Koherenca e vendimeve të kësaj Gjykate është një aspekt i besueshmërisë në këto vendime, por shmangia e kësaj Gjykate, në ndonjë rast, nga praktika e saj e unifikuar, nuk mund të interpretohet si shkelje e standardit të paanshmërisë së gjykatës. Përveç kësaj, kërkuari nuk ka paraqitur ndonjë rrethanë tjetër, që vë në dyshim paanshmërinë e Gjykatës së Lartë në aspektin objektiv dhe subjektiv, rrethana që, në vija të përgjithshme, përshkruhen në nenin

72 të Kodit të Procedurës Civile.

Për pasojë, Gjykata Kushtetuese konkludon se kërkuesi nuk ka asnjë bazë të ligjshme për të vënë në dyshim paanshmërinë e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në shqyrtimin e çështjes së tij.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### VENDIM

**Nr.19, datë 3.5.2007**

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“	“
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Vjollca Meçaj	Anëtare	e	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datë 20.11.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.43/13 Akti që i përket:

**KËRKUES:** 1. **KRYETARI I KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT**, përfaqësuar nga Elvana Tivari, me autorizim.

2. **AVOKATI I POPULLIT**, përfaqësuar nga Florina Nuni, me autorizim.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1. **KUVENDI I SHQIPËRISË**, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.
2. **KËSHILLI I MINISTRAVE**, përfaqësuar nga Enkelejd Alibej, me autorizim.
3. **GJYKATA E LARTË**, përfaqësuar nga Elona Kana, me autorizim.
4. **KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË**, përfaqësuar nga Rozeta Shkëmbi, me autorizim.
5. **PROKURORIA E PËRGGJITHSHME**, përfaqësuar nga Stavri Koçollari, me autorizim.
6. **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 1 pika 1; të nenit 4; të nenit 7 pika 2; të nenit 9; të nenit 10 pikat 1, 2, përsa përfshijnë edhe institucionet e pavarura kushtetuese; si dhe të nenit 20 të ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7, 60, shkronja “a” e pikës 2 të nenit 81, shkronja “a” e nenit 131, shkronjat “ç” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 134 dhe pika 1 e nenit 160 të Kushtetutës së

Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 27-31 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë; nenet 24, 35 dhe 36 të ligjit nr.8454, datë 4.2.1992 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar me ligjin nr.8600, datë 10.4.2000 dhe ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005; nenet 1, 2, 3, 10 dhe 12 të ligjit nr.8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, të ndryshuar me ligjin nr.8599, datë 1.6.2000.

Kërkesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të dispozitave të mësipërme:

- Në aspektin formal – juridik, ligji nuk pajtohet me nenin 6 të Kushtetutës, në të cilin theksohet se “Organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse, përveç rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”, si dhe me shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 81 të Kushtetutës që përcakton se ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta, miratohen me 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

- Në aspektin substancial, dispozitat që kundërshtohen, cenojnë rëndë pavarësinë e institucioneve kushtetuese në tri aspektet e saj: pavarësinë organizative, pavarësinë funksionale dhe pavarësinë financiare, elemente që garantohen, në rastin konkret, respektivisht nga nenet 162/1 dhe 60/2 të Kushtetutës.

- Ky ligj barazon padrejtësisht në trajtim institucionet e pavarura kushtetuese me institucionet e tjera të pavarura të krijuara me ligj. Po kështu, në nenet 7 dhe 9 të këtij ligji shihet qartë tendenca për barazimin dhe unifikimin në trajtim të kabineteve të ministrave me ato të institucioneve të pavarura kushtetuese;

- Këto dispozita bien në kundërshtim edhe me një sërë dokumentesh të rëndësishme ndërkombëtare, mes të cilave janë Deklarata e Limës për Institucionet Supreme të Kontrollit, Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian e shteteve të saj anëtare, Rekomandimi nr. 1615, datë 8 shtator 2003 i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës etj.

Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara theksuan ndër të tjera se:

Gjykata e Lartë: Nenet 1 e 10 bëjnë edhe rregullime të karakterit organizativ dhe funksional të organeve kushtetuese, përfshirë këtu edhe Gjykatën e Lartë. Si i tillë, ligji është *ultra vires*, pra i vesuar në formë. Nga ana tjetër, këto dispozita cenojnë rëndë pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë: Ligji i ri bën rregullime të ndryshme nga ligji organik i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, veçanërisht për probleme që kanë të bëjnë me strukturën dhe organikën e këtij organi kushtetues. Dispozitat që kundërshtohen cenojnë pavarësinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Prokuroria e Përgjithshme: Nenet 1 e 10 të ligjit objekt gjykimi bien në kundërshtim me ligjin organik të Prokurorisë së Përgjithshme. Në këtë mënyrë, ato cenojnë dukshëm pavarësinë e këtij organi kushtetues.

Kuvendi:

- Avokati i Popullit nuk legjitimohet si kërkuar në këtë gjykim. Ai duhet të specifikojë se cilat nene të ligjit objekt shqyrtimi bien ndesh me interesat e këtij institucioni.

- Në aspektin formal-juridik, ligji i ri nuk cenon ligjet organike të organeve kushtetuese. Ai nuk merr përsipër të rregullojë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtyre organeve.

- Miratimi nga Kuvendi i strukturës dhe organikës së institucioneve kushtetuese nuk mund të konsiderohet si ndërhyrje e ligjvënësit. Ky miratim bëhet vetëm në funksion të miratimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor të shtetit. Propozimet për strukturën dhe organikën bëhen nga vetë institucionet kushtetuese.

- Ligji i ri nuk cenon pavarësinë e organeve kushtetuese, përkundrazi është në funksion të forcimit të kësaj pavarësie. Kështu, Këshilli i Ministrave nuk ka më asnjë kompetencë për të caktuar pagat dhe strukturën e këtyre organeve. Rregullimi i ri ligjor siguron një masë më të madhe të paprekshmërisë në ushtrimin e funksioneve nga organet kushtetuese. Nuk ka ndërhyrje në këndvështrim të menaxhimit të buxhetit.

Këshilli i Ministrave:

Ligji që kundërshtohet nuk sjell ndryshime formale në ligjet organike të institucioneve kushtetuese dhe as nuk interferon në to. Ai vetëm merr përsipër të miratojë një kuadër rregullator në

mënyrën e miratimit të pagave të institucioneve të pavarura, përfshirë këtu edhe institucionet kushtetuese. Nuk mund të jetë në kompetencën e këtyre organeve të përcaktojnë vetë strukturën dhe pagën e nëpunësve të tyre.

- Nuk cenohet e drejta e caktimit të strukturës dhe organikës së institucioneve kushtetuese.

- Nuk cenohet e drejta e institucioneve kushtetuese të propozojnë buxhetin e tyre, të cilin e administrojnë vetë. Nuk është masa totale e buxhetit ajo që e bën një institucion të pavarur, por përcaktimi i mjeteve e procedurave të sakta dhe krahasueshmëria në kohë reale me pagat e tjera shtetërore sipas një hierarkie inhereente dhe objektive kushtetuese.

- Ligji që kundërshtohet garanton qëndrueshmëri dhe parashikueshmëri ligjore për punonjësit e institucioneve të pavarura. Ai vendos një balancë hierarkike dhe simetrike mes organeve kushtetuese.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Xhezair Zaganjori, përfaqësuesit e kërkuësve, të subjekteve të interesuara dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

Me propozim të Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”.

Kërkuesit, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Avokati i Popullit i kanë kërkuar Gjykatës Kushtetuese të shfuqizojë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, disa prej dispozitave të këtij ligji dhe konkretisht:

1. Pikën 1 të nenit 1: *“Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i mënyrës së përcaktimit të pagave, shpërblimeve dhe strukturave e organikave të institucioneve kushtetuese...”*.

2. Nenin 4: *“Pagat e funksionarëve të lartë shtetërorë të institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, mandati i të cilëve është me kohë të plotë, përcaktohen në raport me pagën e Presidentit të Republikës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëngjitet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij”*.

3. Pikën 2 të nenit 7: *“Pagat e funksionarëve të kabineteve ndihmëse të titullarëve të tjerë të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, janë të njëjta me pagat e funksionarëve të kabineteve ndihmëse të ministrave dhe përcaktohen nga Këshilli i Ministrave”*.

4. Nenin 9/a): *“Pagat dhe shpërblimet e nëpunësve civilë/nëpunësve të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj, nga niveli sekretar i përgjithshëm deri në specialist, janë të njëjta me pagat dhe shpërblimet e nëpunësve civilë në ministrinë e linjës, sipas përcaktimit të Këshillit të Ministrave...”*.

b) *“Kategorizimi i pozicioneve të punës përgjegjës/shef sektori dhe specialist në këto institucione bëhet me vendim të Kuvendit, në kuadër të miratimit të strukturës dhe të organikës së çdo institucioni, me mbështetjen e Ministrisë së Financave dhe të Departamentit të Administratës Publike”*.

c) *“Përcaktimi i barazvlefshmërisë për funksionet jo tipike në këto institucione miratohet nga Këshilli i Ministrave”*.

5. Pikave 1 dhe 2 të nenit 10, përsa përfshijnë institucionet e pavarura kushtetuese: a) *“Struktura dhe organika e institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj miratohen me vendim të Kuvendit, në bazë të numrit të miratuar në zbatim të ligjit vjetor të Buxhetit të Shtetit, për secilin institucion”; dhe b) “Kabinetet ndihmëse nuk mund të kenë më shumë se dy funksionarë të brendshëm dhe një sekretar; ... Këshilltarë të jashtëm mund të ketë vetëm Presidenti dhe Kryetari i Kuvendit”*.

6. Nenin 20: *“Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen”*.

Sipas kërkuësve, dispozitat e mësipërme bien ndesh me nenin 6 të Kushtetutës, në të cilin theksohet, ndër të tjera, se organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në Kushtetutë

rregullohen me ligjet e tyre përkatëse si dhe me nenin 81, pika 2 shkronja “a” të Kushtetutës, ku vihet në dukje se ligjet për organizimin dhe funksionimin e këtyre organeve duhet të miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Për më tepër, sipas tyre, këto dispozita cenojnë rëndë edhe pavarësinë e organeve kushtetuese, e cila garantohet nga një sërë dispozitash të tjera kushtetuese dhe nga nene të veçanta të ligjeve organike të miratuara në bazë e për zbatim të Kushtetutës.

Pretendimeve të mësipërme u është bashkuar edhe subjekti i interesuar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ndërsa subjektet e interesuara, Gjykata e Lartë dhe Prokuroria e Përgjithshme, në ndryshim nga subjektet e tjera, kërkuan shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën vetëm të pikës 1 të nenit 1 dhe të pikave 1 e 2 të nenit 10 të ligjit që kundërshtohet.

Subjekti i interesuar, Kuvendi, vuri në dyshim, që në fillim, legjitimitimin e Avokatit të Popullit si kërkues në këtë gjykim kushtetues. Sipas tij, legjitimimi i këtij subjekti mund të bëhet vetëm për çështje që lidhen me interesat që ai përfaqëson, interesa që përcaktohen nga objekti i veprimtarisë së këtij institucioni, të cilat në mënyrë të shprehur përmenden në kreun e VI të Kushtetutës dhe në ligjin organik që rregullon organizimin dhe funksionimin e Avokatit të Popullit.

Gjykata Kushtetuese çmon se është i pathemeltë pretendimi i mësipërm i subjektit të interesuar, sipas të cilit edhe Avokati i Popullit nuk legjitimohet si kërkues në këtë gjykim kushtetues. Ndryshe nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili, në përputhje me shkronjën “ç” të nenit 134 të Kushtetutës, paraqitet në këtë rast si kërkues në mbrojtje të interesave të të gjitha organeve kushtetuese, Avokati i Popullit paraqitet si kërkues vetëm për mbrojtjen e interesave të tij në bazë të shkronjës “dh” të pikave 1 dhe 2 të nenit 134. Si interesa të tij janë përcaktuar edhe normat apo rregullat që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni kushtetues, pavarësisht nëse janë vërtetuar ose jo pasojat.<sup>1</sup>

Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kundërshtuan të gjitha pretendimet e kërkuesve dhe të subjekteve të tjera të interesuara, duke theksuar, ndër të tjera, se dispozitat objekt i këtij gjykimi kushtetues, në këndvështrimin juridik-formal, nuk kanë lidhje dhe, për rrjedhojë, ato nuk prekin ligjet organike të organeve kushtetuese. Sipas tyre, përmbajtja e këtyre dispozitave nuk cenon as pavarësinë e këtyre organeve të garantuara nga Kushtetuta dhe ligjet organike përkatëse.

Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e paraqitur duhet të pranohet. Në nenin 7 të Kushtetutës deklarohet shprehimisht se: *“Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”*. Në këtë dispozitë është sanksionuar një prej elementeve më të qenësishme të parimit të shtetit të së drejtës, për të cilin bëhet fjalë që në preambulën e Kushtetutës.

Në demokracinë si formë e qeverisjes, parimi i rëndësishëm i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Për këtë qëllim, pavarësisht se pushteti shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë, brenda tij ka një sërë ndërthurjesh dhe raportesh të ndërsjella që Kushtetuta krijon ndërmjet segmenteve të caktuara të tij. Pra, në thelb, në bazë të këtij parimi, tri pushtetet qendrore duhet të ushtrohen jo vetëm në mënyrë të pavarur, por edhe në mënyrë të balancuar. Kjo gjë arrihet nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që garantojnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm midis pushteteve, pa cenuar dhe pa ndërhyrë në kompetencat e njëri-tjetrit. Pushteti gjyqësor zë një pozicion të veçantë. Ai është i pavarur në dhënien e drejtësisë. Në këtë funksion, gjyqtarët u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Ata duhet të jenë të paanshëm dhe objektivë në gjykimin e çështjeve. Mbi këtë bazë, krijohen raporte të caktuara ndërmjet organeve dhe institucioneve qendrore kushtetuese që përfaqësojnë një nga tre pushtetet kryesore, por duke bërë kujdes që në çdo rast të respektohet pavarësia kushtetuese e secilit prej tyre.

Përveç kësaj, Kushtetuta parashikon edhe krijimin e organeve të tjera qendrore me pozicion neutral ose të ndërmjetëm, vendi dhe roli i të cilëve është mjaft i rëndësishëm në funksionimin e shtetit demokratik, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve. Edhe këto organe

<sup>1</sup> Shih vendimin nr.49, datë 31.7.2000, Vendime të Gjykatës Kushtetuese 2000-2001, Tiranë; faqe 120.

të rëndësishme, në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese, gëzojnë pavarësi që garantohet me dispozita të veçanta të Kushtetutës. Ide qendrore mbetet shpërndarja e pushtetit shtetëror në disa organe apo mekanizma qendrorë kushtetues, të cilët e ushtrojnë atë në mënyrë të pavarur, por duke krijuar gjithnjë mundësinë që secili prej tyre të kontrollohet në mënyrë reciproke. Një zgjidhje e këtillë është veçanërisht e rëndësishme dhe e domosdoshme në regjimin parlamentar të qeverisjes.

Fryma demokratike e shtjelluar më lart përshkon të gjithë Kushtetutën. Në dispozita të veçanta të saj bëhet fjalë shprehimisht për krijimin e organeve apo institucioneve të veçanta kushtetuese, të cilat kanë kompetenca të gjera dhe të rëndësishme në ushtrimin e pushtetit. Mes tyre përmenden qartësisht edhe kërkuesit dhe subjektet e tjera të interesuara në këtë gjykim kushtetues, të tilla si: Kontrolli i Lartë i Shtetit (nenet 162-165), Avokati i Popullit (nenet 60-63), Këshilli i Lartë i Drejtësisë (neni 147), Gjykata e Lartë (nenet 135-137, 139-142 ose 135-146), Prokurori i Përgjithshëm (neni 149) dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (nenet 153-154). Përmes këtyre dispozitave sanksionohet kujdesi për të mbrojtur dhe siguruar sa më mirë pavarësinë e organeve dhe institucioneve kushtetuese, veçanërisht nga ndikimet apo ndërhyrjet e mundshme të politikës ose të ekzekutivit, të cilat mund të cenojnë veprimtarinë e tyre në ushtrimin e funksioneve kushtetuese përkatëse. Duke theksuar pavarësinë e këtyre organeve, është bërë kujdes që Kushtetuta të mos i lërë ata jashtë çdo lloj kontrolli. Ajo vendos raporte të caktuara mes vetë atyre, si dhe mes tyre dhe organeve të tjera qendrore të pushtetit shtetëror, veçanërisht me Kuvendin. Këto raporte krijojnë mundësi për ushtrim kontrolli reciprok dhe për balancim të mjaftueshëm të pushtetit, duke u bazuar në kompetencat dhe funksionin kushtetues të secilit prej tyre.

Një nga mjetet më të rëndësishme për mbrojtjen e pavarësisë së organeve apo institucioneve kushtetuese është veçanërisht përcaktimi i saktë i mekanizmave dhe procedurave për zgjedhjen, emërimin dhe sidomos shkarkimin e drejtuesve apo anëtarëve të tyre. Parashikimi, për këtë qëllim, i mekanizmave të tillë, si shumica e cilësuar në Kuvend, vendimmarrja e Presidentit të Republikës ose e Gjykatës Kushtetuese, vlerësohet si masë e rëndësishme dhe efektive në funksion të ruajtjes dhe forcimit të kësaj pavarësie.

Përveç argumenteve të mësipërme, në funksion të garantimit të pavarësisë së organeve dhe institucioneve kushtetuese shprehen edhe deklaratimet e neneve 6 dhe 81, pika 2, shkronja "a" të Kushtetutës. Sipas nenit 6, "*Organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse...*", ndërsa në nenin 81, pika 2, shkronja "a" theksohet, ndër të tjera, se ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta duhet të miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Pra, qëllimisht Kushtetuta urdhëron që në bazë e për zbatim të saj, i gjithë ndërtimi, organizimi dhe funksionimi i secilit organ kushtetues të bëhet me ligj organik të veçantë, i cili duhet të miratohet jo me shumicë të thjeshtë, ashtu siç miratohet çdo ligj i zakonshëm, por me shumicën e cilësuar prej tri të pestave të deputetëve, gjë që kërkon një konsensus më të gjerë politik. Në këtë kuadër, ligjit organik i është dhënë rëndësi e posaçme në fushën e organizimit dhe të funksionimit të hallkave të ndryshme të organizimit shtetëror, sepse ai rregullon marrëdhëniet në një fushë të caktuar, që ligjvënësi nuk mund ta rregullojë me ligj të zakonshëm. Vullneti i kushtetutëbërësit është shprehur mjaft qartë për këtë çështje.

Referimi i drejtpërdrejtë nga Kushtetuta i mënyrës së miratimit të ligjeve organike të institucioneve të sipërpërmendura u jep atyre fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ata renditen pas Kushtetutës dhe para ligjeve të zakonshme të Kuvendit. Mbështetur në këto konsiderime, Gjykata Kushtetuese rithekson se ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ata të mos prekin rregullimet që përfshihen natyrshëm në sferën ekskluzive të ligjeve organike, përndryshe ato do të binin në kundërshtim me nenet 6 dhe 81, pika 2, shkronja "a" të Kushtetutës.

Nga ana tjetër, kjo do të thotë se edhe ndryshimet që mund t'u bëhen këtyre ligjeve ose dispozitave të veçanta të tyre nuk mund të arrihen nëpërmjet një ligji të thjeshtë, por nëpërmjet një ligji që do të kërkonte sërish të paktën tri të pestat e deputetëve. Kjo gjë arsyetohet me faktin e thjeshtë se rendi juridik nuk përbëhet nga norma juridike të barasvlershme apo me të njëjtën fuqi juridike, përkundrazi ai është një sistem i shkallëzuar, ku normat e së drejtës renditen në bazë të

fuqisë juridike që kanë. Uniteti i këtij sistemi qëndron në varësinë që ekziston ndërmjet normës “krijuese” dhe normës së “krijuar”.<sup>1</sup>

Gjykata Kushtetuese konsideron të rëndësishme të ritheksojë se ligjet organike zbërthejnë më tej dhe konkretizojnë më qartë dhe më mirë pavarësinë e organeve dhe institucioneve kushtetuese që garantojnë sipas rastit dispozita të veçanta të Kushtetutës. Kjo pavarësi nuk është thjesht një privilegj i tyre, por një prerogativë e vërtetë dhe e domosdoshme, e cila u jep më shumë siguri, qëndrueshmëri dhe efikasitet organeve dhe institucioneve kushtetuese në ushtrimin e detyrave të tyre. Nocioni i pavarësisë nuk ka dhe nuk mund të ketë të njëjtën përmbajtje apo kuptim referuar në tërësi të gjithë organeve apo institucioneve kushtetuese. Ai ndryshon në varësi të natyrës së organit, detyrave dhe funksioneve e tij kushtetuese. Megjithatë, marrë në tërësi, duhet vënë në dukje se pavarësia e tyre e garantuar me Kushtetutë dhe me ligjet organike përkatëse, ka si përbërës apo elementë të qenësishëm të saj pavarësinë organizative, pavarësinë funksionale dhe pavarësinë financiare.

Përveç çështjeve që kanë të bëjnë me zgjedhjen, emërimin apo shkarkimin e drejtuesve apo funksionarëve të tjerë të lartë të organeve dhe institucioneve kushtetuese, ndër të tjera, pavarësia organizative gjen shprehje edhe në të drejtën e tyre që të hartojnë e caktojnë vetë, në përputhje me kritere të caktuara, strukturën dhe organikën e tyre, përfshirë këtu edhe të drejtën e caktimit të drejtorëve dhe këshilltarëve, numrin dhe përbërjen e funksionarëve të kabineteve ndihmëse, emërimin e funksionarëve të niveleve më të ulëta, rekrutimin e personelit në nivele të ndryshme, etj.

Pavarësia funksionale e organeve dhe institucioneve kushtetuese është e lidhur ngushtësisht me përmbajtjen e veprimtarisë që këto realizojnë, e cila rregullohet drejtpërsëdrejti dhe e ka themelin e vet në dispozitat përkatëse kushtetuese. Në përputhje me detyrat që i ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm që i jep atij mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve qendrore, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese.

Pavarësia financiare e organeve ose institucioneve kushtetuese nuk ka dhe nuk mund të ketë të njëjtën natyrë me pavarësinë organizative ose me atë funksionale të tyre. Ky aspekt i pavarësisë varet kryesisht nga mundësitë financiare të vet shtetit, të cilat reflektohen periodikisht në buxhetin vjetor të tij, buxhet që miratohet me ligj të veçantë nga Kuvendi, në bazë të projektit të hartuar nga Këshilli i Ministrave. Në këtë proces mbahen mirë parasysh veçanërisht parimet e unitetit dhe universalitetit të buxhetit, si dhe ai i ekonomizmit dhe i kursimit të tij. Po kështu, rol mjaft të rëndësishëm në këtë drejtim luajnë edhe planet për investime publike, politikat ekonomike e sociale, objektivat apo prioritetet e qeverisjes së vendit në periudha të ndryshme të saj, etj.

Mbështetur në sa u trajtua më sipër dhe duke u shprehur në terma të përgjithshëm, pavarësia financiare duhet kuptuar si një financim i tillë i organeve dhe institucioneve kushtetuese, i cili duhet t’u mundësojë atyre të ushtrojnë normalisht veprimtarinë për përmbushjen e funksioneve që Kushtetuta u ka ngarkuar, pa ndërhyrjen ose ndikimin e qeverisë, e politikës apo faktorëve të tjerë të jashtëm me këtë veprimtari, gjë që do të mund të cenonte rëndë ushtrimin e kompetencave tyre. Me fjalë të tjera, pavarësia financiare e këtyre organeve konsiston në të drejtën për të propozuar në Kuvend buxhetin e tyre vjetor, veçanërisht në të drejtën e menaxhimit të pavarur të këtij buxheti në përputhje me ligjin. Megjithëse Buxheti i Shtetit përbën akt politik që merr jetë përmes bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të Këshillit të Ministrave me Kuvendin, për sa u përket shqyrtimit dhe miratimit të zërave buxhetorë të organeve dhe institucioneve kushtetuese, sipas rastit dhe përmes konsultimeve, është e domosdoshme të merren parasysh edhe kërkesat dhe nevojat e tyre për ushtrimin normal të funksioneve kushtetuese për të cilat ata janë krijuar. Nga ana tjetër, dispozitat kushtetuese dhe ligjet organike përkatëse përcaktojnë qartazi se menaxhimi i këtij buxheti në përputhje me ligjin duhet t’u lihet në dorë vetë këtyre organeve. Sigurisht, ato i dinë dhe i vlerësojnë më mirë se kushdo tjetër kërkesat dhe problemet e tyre, nevojat për investime, objektivat që synojnë të arrijnë, etj.

---

<sup>1</sup> Hans Kelsen, *Reine Rechtslehre* (1960), fq.228

Gjykata Kushtetuese tërheq vëmendjen se të tri elementeve të pavarësisë së organeve dhe institucioneve kushtetuese duhet t'u kushtohet, sipas rastit, vëmendje e posaçme, gjë që diktohet jo vetëm nga dispozitat e Kushtetutës, por edhe nga ligjet organike që rregullojnë veprimtarinë e secilit prej tyre.

Kërkesit dhe disa nga subjektet e interesuara në këtë gjykim kushtetues pretendojnë se dispozitat që kundërshtohen jo vetëm e cenojnë këtë pavarësi, por ato duhen shfuqizuar si jokushtetuese në këndvështrimin formal, sepse janë pjesë e një ligji të zakonshëm, cili ndërhyr dhe ndryshon dispozita të rëndësishme të ligjeve organike që e garantojnë këtë pavarësi.

Gjykata Kushtetuese çmon se Kuvendi, si organi më i lartë përfaqësues dhe mbartës i sovranitetit të popullit është padyshim organi qendror dhe më i rëndësishëm i pushtetit shtetëror. Si i tillë, Kuvendi shfaqet para së gjithash si organ ligjvënës dhe në ushtrimin e këtij funksioni kryesor, ai mbështetet së pari te dispozitat kushtetuese, sepse ligjet që miraton duhet të nxirren në bazë dhe për zbatim të tyre. Në këtë kuptim, ai shfaqet edhe si interpretues i parë i normës kushtetuese. Hapësira e këtij interpretimi varet nga karakteri dhe natyra e dispozitave kushtetuese që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me ligjin që do të miratohet ose me dispozita të veçanta të tij. E rëndësishme është të ruhen, në çdo rast, vlerat dhe parimet themelore të deklarimeve kushtetuese. Brenda kësaj hapësire, Kuvendi ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, të cilat janë përcaktuar si prioritet në programin zgjedhor të shumicës parlamentare. Përveç kësaj, Kuvendi, përmes procesit ligjvënës, ka detyrën dhe përgjegjësinë t'u përgjigjet në mënyrë të vazhdueshme, me realizëm, sa më shpejt dhe sa më drejt edhe prioriteteve apo problemeve të ndryshme të vendit. Në të gjitha rastet, është e rëndësishme të ritheksohet se ligji i ri apo dispozita të veçanta të tij të mos bien ndesh me dispozitat kushtetuese, pasi Kushtetuta qëndron në majë të piramidës së akteve normative që kanë fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ligji që kundërshtohet ka pasur si qëllim kryesor rregullimin e mënyrës së përcaktimit të pagave, shpërblimeve dhe strukturave organike të institucioneve kushtetuese e të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, gjë që deklarohet shprehimisht që në pikën 1 të nenit 1. Përmes vendosjes së një ekuilibri hierarkik mes organeve kushtetuese është synuar të ndërtohet një piramidë e qëndrueshme e pagave buxhetore. Kështu, ndër të tjera, ligji vendos, përmes koeficientëve, raporte të caktuara ndërmjet pagave të titullarëve të organeve dhe institucioneve kushtetuese me pagën e Presidentit të Republikës, e cila qëndron në majën e piramidës së pagave dhe përcaktohet çdo vit në ligjin për Buxhetin e Shtetit, sipas propozimit që bën Këshilli i Ministrave.

Pa hyrë në vlerësimin e hollësishëm të qëllimit të ligjit, Gjykata Kushtetuese çmon se mjetet e përdorura për arritjen e këtij qëllimi nuk janë kushtetuese. Dispozitat që kundërshtohen prekin mjaft dispozita kushtetuese dhe dispozita të tjera të ligjeve organike, që garantojnë pavarësinë e organeve dhe institucioneve kushtetuese të lartpërmendura. Konkretisht, në ligjin nr.9584, datë 17.7.2006, theksohet, ndër të tjera, se përveç mënyrës së përcaktimit të pagave, ligji rregullon edhe "çështjen e shpërblimeve dhe strukturave organike të institucioneve kushtetuese" (pika 1 e nenit 1), se "kategorizimi i pozicioneve të punës përgjegjës/shef sektori dhe specialist në këto institucione bëhet me vendim të Kuvendit, në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së çdo institucioni, me mbështetjen e Ministrisë së Financës dhe Departamentit të Administratës Publike" (pika 2 e nenit 9), se "struktura dhe organika e institucioneve kushtetuese ... miratohen me vendim të Kuvendit" (pika 1 e nenit 10), dhe se "kabinetet ndihmëse nuk mund të kenë më shumë se dy funksionarë të brendshëm dhe një sekretar ...". Të gjitha këto çështje përfshihen shprehimisht në objektin e rregullimit të ligjeve organike përkatëse. Siç u theksua më sipër, çështjet e strukturës dhe organikës përbëjnë çështje ekskluzive të organeve dhe institucioneve kushtetuese si shprehje e pavarësisë organizative dhe funksionale të tyre në ushtrimin e detyrave kushtetuese (nenet 10 e 12 të ligjit organik të Kontrollit të Lartë të Shtetit; nenet 31, 32 e 35 të ligjit organik të Avokatit të Popullit; nenet 7, 9, 26 dhe 28 të ligjit organik të Gjykatës së Lartë; nenet 11-17 i ligjit organik të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; nenet 8/c dhe 9/2 të ligjit organik për Prokurorinë, etj).

Në ligj theksohet gjithashtu se "pagat e funksionarëve të lartë shtetërorë të këtyre institucioneve, përcaktohen në raport me pagën e Presidentit të Republikës" (neni 4), se "pagat e funksionarëve të kabineteve ndihmëse ... janë të njëjta me pagat e funksionarëve të kabineteve

*ndihmëse të ministrave dhe përcaktohen nga Këshilli i Ministrave” (pikat 1 dhe 2 të nenit 7) dhe se “pagat dhe shpërblimet e nëpunësve civilë/nëpunësve të institucioneve kushtetuese ... nga niveli sekretar i përgjithshëm deri në specialist, janë të njëjta me pagat dhe shpërblimet e nëpunësve civilë në ministritë e linjës” (pika 1 e nenit 9). Për këto çështje ka rregullime të posaçme në ligjet organike, të cilat respektojnë, brenda hapësirës kushtetuese, pavarësinë financiare të tyre për këtë qëllim. Në nene të posaçme të ligjeve organike të sipërcituara është përcaktuar si kompetencë e vetë organeve vendosja e strukturave organizative. Struktura administrative përmban në vetvete klasifikimin e nëpunësve civilë sipas punës që ata kryejnë. Ky klasifikim i pozicioneve të punës, që vlen për të gjithë administratën publike, përcaktohet në nenin 11 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Për Statusin e Nëpunësit Civil”. Mbi bazën e këtij klasifikimi është ndërtuar në përgjithësi struktura administrative e institucioneve qendrore dhe atyre të pavarura. Ky ligj, në pikën 6 të nenit 11, bën një dallim për institucionet e pavarura, duke parashikuar mundësinë që këto institucione të “bëjnë klasifikime ose të caktojnë nivele të ndryshme brenda secilës klasë në institucionet e pavarura përkatëse”.*

Klasifikimi i nëpunësve, përveçse lidhet ngushtësisht me detyrat që do t'i ngarkohen secilit prej nëpunësve të emëruar në pozicionin përkatës, pasi ky është edhe qëllimi i këtij klasifikimi, përmban në vetvete edhe masën e shpërblimit që do të përfitojnë këta nëpunës për detyrën që kryejnë. Është vështirë të ndahet koncepti i shpërblimit nga ai i pozicionit të vendit të punës ose strukturës në administratën publike, pasi një nga parimet në të cilat mbështetet administrata publike është se shërbimi civil përbën një shërbim ose punë që kryhet kundrejt pagës. Për këtë qëllim, ligji “Për statusin e nëpunësit civil” parashikon edhe elementet përbërës të pagës si dhe shtesat përkatëse sipas pozicionit të punës (neni 18 – Struktura e pagës dhe shpërblimit). Siç shihet, struktura ose organika e administratës duhet të kuptohen të lidhura ngushtësisht me elementin “pagë” ose “shpërblim”.

Përsa më sipër, Gjykata Kushtetuese, mbështetur në kuptimin e dispozitave të neneve 6 dhe 81, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës, nxjerr përfundimin se dispozitat që kundërshtohen nga kërkuesit nuk duheshin miratuar me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Kuvendit, por me tri të pestat e tyre, pasi problemet që ato trajtojnë përbëjnë në mënyrë të dukshme objekt rregullimi të ligjeve organike përkatëse të organeve dhe institucioneve kushtetuese.

Kërkuesit kanë pretenduar, gjithashtu, se ligji objekt shqyrtimi barazon padrejtësisht në trajtim institucionet e pavarura kushtetuese me institucionet e tjera të pavarura të krijuara me ligj dhe se në nenet 7 dhe 9 të këtij ligji shfaqet qartazi prirja për barazimin dhe unifikimin në trajtim të kabineteve të ministrave me ato të institucioneve të pavarura kushtetuese. Gjykata Kushtetuese çmon se argumentet e paraqitura në mbështetje të këtyre pretendimeve janë të mangëta dhe mbi bazën e tyre nuk mund të konkludohet papajtueshmëria me Kushtetutën e dispozitave që kundërshtohen. E rëndësishme është të provohet nëse këto dispozita prekin apo cenojnë dispozitat kushtetuese dhe ato të ligjeve organike që garantojnë pavarësinë e institucioneve kushtetuese në ushtrimin e detyrave të tyre. Përsa kohë që këto kërkesa apo standarde respektohen, nuk mund të shërbejnë si argumente për të shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën dispozita të caktuara, me pretendimin se ato nuk bëjnë diferencim të mjaftueshëm në paga ndërmjet institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, apo vënë në pozita të njëjta kabinetet e ministrave me ato të institucioneve të pavarura kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se në vijim të arsyetimit të mësipërm duhet pranuar kërkesa për shfuqizimin edhe të nenit 20 të ligjit nr.9584, datë 17.07.2006. Përmbajtja e këtij neni nuk mund të gjejë më veprim mbi dispozitat që Gjykata Kushtetuese i gjen në kundërshtim me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese, në përfundim të gjykimit, arrin në konkluzionin se dispozitat objekt shqyrtimi duhet të shfuqizohen vetëm sa u takon rregullimeve që prekin mënyrën e funksionimit të institucioneve të pavarura kushtetuese. Rregullimet lidhur me institucionet e pavarura të krijuara me ligj nuk janë objekt i këtij shqyrtimi kushtetues.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 72 e vijues të ligjit

nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 1/1, nenit 4, nenit 7/2, nenit 9, nenit 10/1, 2 dhe nenit 20 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, vetëm për sa i përket institucioneve të pavarura kushtetuese.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### VENDIM

**Nr.20, datë 4.5.2007**

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 6.11.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.40/10 Akti që i përket:

**KËRKUES: NJË GRUP DEPUTETËSH TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË** (jo më pak se një e katërta e deputetëve), përfaqësuar nga Spartak Braho, me autorizim.

**NJË GRUP DEPUTETËSH TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË** (jo më pak se një e pesta e deputetëve), përfaqësuar nga Spartak Braho, me autorizim.

**SUBJEKT I INTERESUAR: KUVENDI I SHQIPËRISË**, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj e Riçard Marku, me autorizim.

**OBJEKTI: 1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt** (jo më pak se një e katërta e deputetëve), duke shpallur si antikushtetues:

a) vendimin nr.60, datë 27.09.2006 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e objektit të kërkesës së 35 deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e lidhjeve nepotike, konfliktin e interesit dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin prej tyre për Kryeministrin, familjarët dhe të afërmit e tij”;

b) vendimin nr.59, datë 18.09.2006 “Për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike”.

2. Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.59, datë 18.09.2006 të Kuvendit të Shqipërisë “Për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike”.

Një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, me cilësinë e dyfishtë të subjektit legjitimues për një gjykim kushtetues (jo më pak se një e katërta e deputetëve dhe jo më pak se një e pesta e tyre) i ka paraqitur Gjykatës Kushtetuese dy kërkesa, me objekt të dallueshëm nga forma, por të njëjlojtë në përmbajtje.

Në bazë të neneve 131, shkronjat “c dhe ç”; 134/1, shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 54, 55 dhe 56 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kërkuesi ka inicuar, nga njëra anë, një gjykim të karakterit kushtetues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pakicës parlamentare dhe Kuvendit të Shqipërisë dhe, nga ana tjetër, një gjykim për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së normës juridike, duke parashtruar pretendimet e tij në këto drejtime kryesore:

- Një e katërta e deputetëve përbën subjekt kushtetues, të cilit vullneti i shumicës parlamentare nuk mund t'i kufizojë ushtrimin e kompetencës kushtetuese për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar. Kërkesa e pakicës parlamentare ka pasur për objekt hetimin parlamentar për një çështje me natyrë të përveçme, për atë të pasurisë së Kryeministrit dhe jo për hetimin e gjithçkaje dhe për çdo gjë.

- Kuvendi, me vendimin nr.60, datë 27.9.2006, nuk ka miratuar kërkesën e një të katërtës së deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor, duke arsyetuar se shkak ligjor për refuzimin e saj ka qenë objekti i njëjtë dhe tërësisht i ezauruar me vendimin nr.59, datë 18.6.2006.

- Të dyja vendimet e Kuvendit, që përbëjnë dhe bazën për fillimin e këtij gjykimi kushtetues, kanë cenuar në thelb të drejtën kushtetuese të një të katërtës së deputetëve, duke shkaktuar mosmarrëveshje kompetencash ndërmjet pushtetit të pakicës parlamentare dhe Kuvendit të Shqipërisë.

- Në funksionet kushtetuese të Kuvendit nuk përfshihet verifikimi i pasurive të ndokujt, përderisa sipas ligjit ka organe të pavarura dhe të specializuara që e ushtrojnë këtë detyrë. Paqartësia e objektit të hetimit të komisionit parlamentar të ngritur nga Kuvendi është në kundërshtim me nenin 77/2 të Kushtetutës, si dhe me vendimin nr.18, datë 14.5.2003 të Gjykatës Kushtetuese.

- Ngritja e komisionit hetimor parlamentar nuk është bërë mbi bazën e ekzistencës së një çështjeje të veçantë, por të disave të tilla, të cilat kanë të bëjnë me verifikimin e pasurisë, lidhjeve nepotike dhe me konfliktin e interesave. Në rastin e dhënë, çështja nuk ekziston, por ajo kërkohet të zbulohet.

- Rrethi i subjekteve të përfshira në objektin e hetimit të komisionit hetimor del jashtë funksionit të kontrollit parlamentar. Hetimi parlamentar shtrihet edhe mbi funksionarë të lartë, të cilët janë hetuar më parë për të njëjtën çështje.

- Objekti i hetimit parlamentar shtrihet dhe për një periudhë kohore kur nuk ekzistonte ligji dhe as përkufizimi ligjor për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe për konfliktin e interesave.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar kërkoi rrëzimin e të dyja kërkesave, duke parashtruar pretendimet e tij në këto drejtime kryesore:

- Mosmarrëveshja e kompetencës ndërmjet pakicës dhe shumicës parlamentare nuk është me natyrë kushtetuese, sepse pakica dhe shumica parlamentare nuk përbëjnë pjesë pushtetesh të ndryshme, por secila i përket të njëjtit pushtet, atij legjislativ.

- Kërkuesi nuk ka evidentuar formalisht llojin, numrin dhe datën e aktit të Kuvendit, nga i cili mund të ketë lindur mosmarrëveshja e kompetencës ndërmjet pushteteve.

- Vendimi i Kuvendit nr.59, datë 18.9.2006 nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative, në kuptim të nenit 131, shkronja “c” të Kushtetutës.

- Objekti i kërkesës të një të katërtës së deputetëve për krijimin e komisionit parlamentar për hetimin e Kryeministrit ka qenë i njëjtë dhe i ezauruar plotësisht me vendimin nr.59, datë 18.9.2006 të Kuvendit, i miratuar para vendimit për refuzimin e kërkesës së pakicës parlamentare.

- Shumica parlamentare, duke zgjeruar rrethin e subjekteve që do t'i nënshtrohen hetimit parlamentar, nuk ka disponuar mbi objektin e kërkesës së pakicës parlamentare. Zgjerimi i rrethit të këtyre subjekteve i shërben më mirë luftës kundër korrupsionit, si dhe krijon mundësinë e grumbullimit të shumë informacioneve për të rritur masat për eliminimin e shkaqeve që e favorizojnë këtë fenomen negativ të shoqërisë.

- Çështja që përbën objektin e hetimit në komisionin e ngritur nuk është një çështje e zakonshme, por një çështje e veçantë.

- Periudha kohore që është parashikuar të kontrollohet nuk ka rëndësi thelbësore për

çështjen, sepse në Kushtetutë dhe në aktet e tjera ligjore nuk ka ndonjë dispozitë që të kufizojë hetimin parlamentar.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuarit, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

#### VËREN:

Kuvendi i Shqipërisë, mbi propozimin e deputetëve të shumicës parlamentare, me vendimin nr.59, datë 18.9.2006, ka miratuar ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike, si dhe të personave të lidhur me ta, për periudhën 1992-2006.

Me vendimin nr.60, datë 27.9.2006, Kuvendi ka refuzuar kërkesën e deputetëve të pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor për verifikimin e lidhjeve nepotike, konfliktin e interesit dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin prej tyre për Kryeministrin, familjarët dhe të afërmit e tij, me arsyetimin se objekti i kërkesës së mësipërme ka qenë i njëjtë dhe tërësisht i ezauruar me objektin e vendimit nr.59, datë 18.9.2006.

Një grup prej 30 deputetësh të Kuvendit, me cilësinë e subjektit të legjitimuar (jo më pak se një e pesta e deputetëve), në bazë të neneve 124/1; 131, shkronja “c” dhe 134, pika 1 shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe ka kërkuar *shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.59, datë 18.9.2006 të Kuvendit të Shqipërisë “Për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike”.*

Gjithashtu, një grup prej 36 deputetësh të Kuvendit, me cilësinë e subjektit kushtetues në konflikt (jo më pak se një e katërta e deputetëve), në bazë të neneve 77; 131, shkronja “ç” të Kushtetutës dhe të neneve 54, 55 dhe 56 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i është drejtuar kësaj Gjykate me një tjetër kërkesë, me objekt *zgjdhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe pakicës parlamentare dhe shpalljen si antikushtetues të dy vendimeve të sipërcituara të Kuvendit.*

Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkesa me objekt kontrollin e kushtetutshmërisë së normës juridike ka natyrë të njëjtë, në substancë dhe në argumentet e paraqitura; me njërin nga pretendimet e parashtruara në kërkesën me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, paraqitur nga jo më pak se një e katërta e deputetëve të Kuvendit. Për këtë arsye dhe me qëllimin e arritjes së efektivitetit të gjykimit, ajo i bashkon kërkesat e sipërpërmendura në një çështje të vetme dhe ia nënshton ato shqyrtimit kushtetues. Ky bashkim nuk e pengon Gjykatën Kushtetuese të vlerësojë dhe të përcaktojë qëndrimin e vet ndaj pretendimeve të ngritura dhe ndaj çdo argumenti në mbështetje të tyre të paraqitur nga kërkuarit.

Grupi prej jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, në cilësinë e subjektit të legjitimuar, ka arsyetuar për papajtueshmërinë me Kushtetutën, posaçërisht me nenin 131, shkronja “c” të saj, të vendimit nr.59, datë 18.9.2006 të Kuvendit të Shqipërisë. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar e ka mbështetur mbrojtjen e vet në argumentin e mungesës së juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e vendimit të sipërcituar të Kuvendit, për shkak të karakterit individual dhe jo normativ të përmbajtjes së tij. Ky vendim, sipas tij, përmban rregulla konkrete e masa me karakter organizativ që përcaktojnë vetëm formën e kontrollit parlamentar dhe nuk vendos rregulla me karakter të përgjithshëm dhe abstrakt, karakteristikë kjo e ligjeve dhe akteve të tjera juridike që i nënshtrohen kontrollit kushtetues.

Gjykata Kushtetuese çmon se nuk mund të përjashtojë apriori nga kontrolli kushtetues çdo akt me natyrë individuale. Megjithatë, ajo ka pranuar se nuk ka juridiksion për akte të kësaj natyre kur zhvillon gjykim abstrakt dhe veçanërisht në vështrim të formulimit të dispozitës së shkronjës “c” të nenit 131 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, do të konsiderohet i drejtë pretendimi i subjektit të interesuar për karakterin individual dhe jo normativ të vendimit të sipërcituar dhe, për këtë arsye,

kërkesa e iniciuar nga jo më pak se një e pesta e deputetëve duhet rrezuar për mungesë juridiksioni.

Kërkesa e paraqitur nga jo më pak se një e katërta e deputetëve ka një objekt të ndryshëm në formë nga kërkesa e sipërcituar. Kërkuesi është paraqitur me cilësinë e *subjektit në konflikt* që pretendon se është cenuar drejtpërdrejt në kompetencat e tij kushtetuese për shkak të vendimmarrjes parlamentare. Kërkesa e pakicës parlamentare, në rastin në shqyrtim, e jo më pak se një të katërtës së deputetëve, për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e lidhjeve nepotike, konfliktin e interesit dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin prej tyre për Kryeministrin, familjarët dhe të afërmit e tij, është refuzuar nga Kuvendi me vendimin nr.60, datë 27.9.2006. Mosmiratimi i kësaj kërkesë, me arsyetimin se një çështje e tillë është ezauruar me vendimin nr.59, datë, 18.9.2006, si dhe devijimi i objektit të hetimit dhe shtimi i subjekteve për t'u kontrolluar pa pëlqimin e pakicës, e ka penguar këtë në ushtrimin e kompetencës së saj kushtetuese. Sipas kërkuesit, miratimi i akteve të tilla juridike përbëjnë shkakun kryesor për konfliktin kushtetues të krijuar ndërmjet pushtetit të pakicës parlamentare dhe Kuvendit. Baza juridike së cilës i është referuar kërkuesi, përbëhet nga nenet 77 dhe 131, shkronja “ç” e Kushtetutës, si dhe nga nenet 54, 55 dhe 56 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Përderisa kërkuesi e ka parashtruar çështjen si mosmarrëveshje kompetence ndërmjet pushteteve, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të analizojë pikësëpari juridiksionin kushtetues mbi çështje të kësaj natyre, në kuptim të nenit 131, shkronja “ç” të Kushtetutës, për të konkluduar edhe për pozitën juridike të subjekteve që iniciojnë këto gjykime.

Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushteteve, si një ndër drejtimet kryesore të drejtësisë kushtetuese, është trajtuar në jurisprudencën kushtetuese shqiptare. Nëpërmjet disa vendimeve,<sup>1</sup> Gjykata Kushtetuese e ka zhvilluar këtë doktrinë, duke konsoliduar njëkohësisht qëndrimin e saj se dispozita e shkronjës “ç” të nenit 131 të Kushtetutës përfshin jo vetëm mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes klasike të pushteteve (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe pushtet qendror e qeverisje vendore), por edhe ato që mund të lindin midis organesh a subjektesh që nuk bëjnë pjesë, në mënyrë të përcaktuar e kategorike në secilin prej tyre.

Një mosmarrëveshje kompetence që paraqitet për zgjidhje para Gjykatës Kushtetuese duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato që i njej Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatën Kushtetuese përqendrohet pikësëpari në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës për sa i takon funksioneve të nivelit kushtetues, duke gjetur dhe cilësuar të papajtueshëm me Kushtetutën shkakun vendimtar që ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes.

Në çështjen në shqyrtim, jo më pak se një e katërta e deputetëve, si subjekt kushtetues, pretendon se i është mohuar kompetenca për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar. Gjykata Kushtetuese, në vendimin për interpretimin përfundimtar të nenit 77 të Kushtetutës,<sup>2</sup> ka konkluduar si për statusin kushtetues me të cilin paraqitet pakica parlamentare, ashtu edhe për natyrën juridike të së drejtës së kësaj të fundit për ngritjen e komisionit hetimor.

Gjykata Kushtetuese e cilëson si “*kompetencë kushtetuese*” të drejtën e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar. Duke e veshur një të katërtën e deputetëve me këtë pushtet, Kushtetuta “... *institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushtet i pakicës parlamentare*”, që realizohet “... *në mënyrë të pavarur...*” dhe që është “... *i pakufizuar nga vullneti i shumicës*”. E drejta e kontrollit hetimor i është njohur pakicës parlamentare, e cila, duke i pasur të kufizuara mjetet, “*mund ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues*”.

Kushtetuta “... *ka evituar, veçanërisht për ngritjen e komisionit, kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit*” dhe, mbi këtë bazë, Kuvendi “... *ka detyrimin që të mos e diskutojë ngritjen e komisionit*” kur kjo kërkohet nga pakica parlamentare. Objekti i hetimit “... *nuk mund të reduktohet nga Kuvendi deri në atë masë sa t'ia bëjë të pamundur komisionit kryerjen e veprimtarisë*”. Prandaj, jurisprudenca e ka pranuar tashmë se “... *e drejta e pakicës për të disponuar mbi objektin e hetimit e kufizon kompetencën e shumicës për të ndryshuar këtë objekt pa pëlqimin e*

<sup>1</sup> Vendimet nr.26, datë 4.12.2006 dhe nr.29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

<sup>2</sup> Vendimi nr.18, datë 14.5.2003, në “Vendime të Gjykatës Kushtetuese 2003”, Tiranë, faqe 84.

*pakicës, me përjashtim të rasteve, kur nga qëllimi dhe objekti i hetimit konstatohen se preken parimet kushtetuese.”<sup>1</sup>*

Mbi bazën e këtyre konkluzioneve të nxjerra nga jurisprudenca e saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të ritheksojë se çdo organ juridiksional, qoftë si institucion a organ pushteti, në kuptimin klasik administrativ të tij, apo dhe si subjekt që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë të garantuar nga Kushtetuta, konsiderohet i legjitimuar për të qenë palë në mosmarrëveshje pushtetesh.

Duke iu referuar rastit në shqyrtim, konstatohet se ndërmjet pakicës parlamentare (jo më pak se një e katërta e deputetëve) nga njëra anë dhe Kuvendit nga ana tjetër, ka lindur në realitet një mosmarrëveshje për ushtrimin e së njëjtës kompetencë kushtetuese. Kushtetuta i njej pakicës parlamentare kompetencë hetimi, pengimi i së cilës përbën konflikt kushtetues kompetence. Vendimi i Kuvendit nr.60, datë 27.9.2006 për mosmiratimin e kërkesës së 35 deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar, ka cenuar këtë të drejtë kushtetuese të pakicës parlamentare. Gjykata Kushtetuese konstaton se kompetenca për të cilën ka lindur konflikti, është me natyrë kushtetuese dhe e parashikuar drejtpërdrejt prej Kushtetutës, gjë që përbën argument të mjaftueshëm për të legjitimuar pakicën parlamentare si pjesë e Kuvendit, në këtë gjykim kushtetues.

Sipas Kushtetutës, Kuvendi dhe pakica parlamentare kanë të drejtën e ngritjes së komisionit hetimor dhe asnjëri prej tyre nuk mund të pengohet në ushtrimin e kësaj prerogative kushtetuese. Gjykata Kushtetuese rithekson se ngritja e komisionit hetimor parlamentar bëhet e detyrueshme kur kërkohet nga pakica parlamentare në cilësinë e subjektit kushtetues. Në rastin e dhënë, përderisa nuk janë ngritur pretendime për cenime të parimeve kushtetuese në objektin e hetimit, Kuvendi nuk duhej që një kërkesë të tillë t’ia nënshtrohte procedurës së vendimmarrjes. Për rrjedhojë, vendimi i Kuvendit, vetëm për sa i takon refuzimit që i bën kërkesës së pakicës për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar, nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Grupi prej jo më pak se një e katërta e deputetëve ankohet edhe ndaj vendimit të Kuvendit nr.59, datë 18.9.2006, sepse pikërisht ky vendim ka shërbyer si argument për të mohuar kërkesën e tij për ngritjen e komisionit hetimor. Lidhja që vetë Kuvendi i Shqipërisë ka konstatuar ndërmjet arsyes së refuzimit të kërkesës së grupit prej jo më pak se një të katërtës së deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar dhe objektit të njëjtë e tërësisht të ezauruar të hetimit në vendimin nr.59, datë 18.9.2006, e bën të domosdoshme për Gjykatën Kushtetuese analizën e hollësishme të shkaqeve që kanë krijuar mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet dy subjekteve kushtetuese.

Duke analizuar situatën juridike të krijuar, situatë e karakterizuar nga gjendja konfliktuale, rezulton se shkak i lindjes së mosmarrëveshjes ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit në ushtrimin e kompetencave kushtetuese të tyre duhet kërkuar pikërisht në dy vendimet e sipërcituara. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese, në çështjen në shqyrtim, mbetet zgjidhja e kësaj mosmarrëveshje kompetence me anë të eliminimit të shkaqeve që e kanë lindur atë, si dhe shqyrtimit të kushtetutshmërisë së objektit të hetimit, qoftë në vendimin nr.59, datë 18.9.2006, ashtu dhe në vendimin nr.60, datë 27.9.2006 të Kuvendit.

Sa i përket qëndrimit që duhet mbajtur për të vlerësuar kushtetutshmërinë e një komisioni hetimor, Gjykata Kushtetuese është shprehur në vendimin e saj nr.18, datë 14.5.2003, në të cilin ajo ka tërhequr vëmendjen, ndërmjet të tjerash, për parimet që duhen respektuar gjatë fazave të realizimit të qëllimit të hetimit: në çastin e formulimit të objektit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së komisionit dhe në hartimin e konkluzioneve përfundimtare të hetimit.

Kuvendi mund të ushtrojë hetim nëpërmjet komisioneve të tij edhe mbi zyrtarët e institucioneve kushtetuese për çështje të veçanta, të cilat përfshihen brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe që lejohen nga Kushtetuta, por një hetim i tillë nuk mund të zëvendësojë apo të dublojë prerogativat e organeve të tjera të pavarura. Kuvendi mund të ngrejë komision hetimor kur përmbushen të paktën tre kushte kryesore: 1) çështja duhet të ketë të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera për të cilat ai është i autorizuar të marrë masa ligjore; 2) objekti i hetimit duhet të fokusohet në çështje ose në subjekte konkrete; 3) duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të

<sup>1</sup> Të gjitha citimet janë shkëputur nga Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 14.5.2003. Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, viti 2003, faqe 84.

mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e një çështje, për të cilën është i nevojshëm hetimi. Në rastin në shqyrtim, çështja shtrohet për të konkluduar nëse objekti i hetimit të vendimit nr.59, datë 18.9.2006 të Kuvendit i përmbush ose jo kërkesat thelbësore që i nevojiten një hetimi parlamentar kushtetues.

Përkufizimi i objektit të hetimit përbën hapin e parë nga ku do të përcaktohet edhe ecuria e mëtejshme e hetimit parlamentar. Objekti i hetimit, i parashtruar në mënyrë të qartë e të saktë, duhet të përmbajë fakte ose tërësi faktesh, nga të cilat merr shkas hetimi parlamentar dhe shpjegon se çfarë hetohet. Veç kësaj, objekti i hetimit duhet të jetë i përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme, kusht ky që kërkohet për respektimin e parimit të shtetit të së drejtës, respektimit të të drejtave themelore, të parimit të ndarjes së pushteteve si dhe të kompetencave të kufizuara që disponon një komision hetimor.

Qëndrimet, tashmë të konsoliduara, që ka mbajtur jurisprudenca kushtetuese shqiptare për domosdoshmërinë e respektimit të parimeve dhe koncepteve kushtetuese gjatë kryerjes së hetimeve parlamentare, janë fokusuar drejt argumentit se funksioni kontrollues i Kuvendit nuk mund të qëndrojë jashtë natyrës së tij ligjvënëse. Ushtrimi i funksionit të hetimit parlamentar nuk mund të realizohet duke ndërhyrë në veprimtarinë e organeve të pavarura. Natyra e hetimit parlamentar nuk është e njëlojtë dhe nuk mund të barazohet me hetimin që realizojnë në bazë të ligjit organet e tjera të pavarura apo të specializuara për kryerjen e një funksioni të tillë. Nuk mund të konsiderohet se është në përputhje me parimet kushtetuese një hetim i iniciuar që nuk i përket veprimtarisë së legjislativit dhe qëllimeve të saj. Ky instrument i rëndësishëm nuk mund të përdoret në mënyrë abuzive dhe tej hapësirës kontrolluese që Kushtetuta i njej Kuvendit.

Duke e krahasuar objektin e hetimit parlamentar me objektin e disa ligjeve të posaçme që veprojnë në fushën e kontrollit të deklarimit të pasurive dhe të parandalimit të konfliktit të interesave të të zgjedhurve dhe të disa funksionarëve publikë, Gjykata Kushtetuese nuk konstaton ndonjë dallim cilësor ndërmjet veprimtarisë së komisionit hetimor parlamentar dhe veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive. Në këtë mënyrë, objekti i hetimit, sipas vendimit të sipërcituar të Kuvendit, nuk e ndalon dublimin dhe as shmangien e një institucioni shtetëror të pavarur, siç është ky Inspektorat, në ushtrimin e kompetencave ligjore të tij nga një instrument i një pushteti tjetër. Për rrjedhojë, një hetim i tillë e deformon natyrën kushtetuese të funksionit të kontrollit parlamentar.

Kushtetutshmëria e objektit të hetimit parlamentar varet gjithashtu nga prania apo përfshirja në të e konceptit kushtetues “*çështje e veçantë*”, si edhe nga metodat dhe instrumentet që i vihen në dispozicion komisionit për të realizuar qëllimin për të cilin është krijuar. Sipas qëndrimit të mbajtur nga jurisprudenca janë kushtetuese, “*çështjet e hetimit të trajtuara në aspektin e kontrollit dhe të zbatimit të ligjit, të njohjes e verifikimit të një ngjarjeje, a veprimtarie dhe që nxisin iniciativat për propozime e miratime ligjesh, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shoqërinë e shtetit dhe nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, përfshihen në konceptin kushtetues çështje e veçantë.*”<sup>1</sup>

Në këtë mënyrë, objekti i hetimit të komisionit parlamentar, i fokusuar në një çështje të veçantë dhe jo në një çështje të përgjithshme, evidenton njëkohësisht edhe qëllimin e hetimit parlamentar. Nga kjo pikëpamje, Gjykata Kushtetuese thekson se komisioni hetimor parlamentar ngrihet kur ekziston në fakt çështja e veçantë dhe jo për të parë nëse mund të zbulohet ose të gjendet ndonjë e tillë në të ardhmen.

Pas analizës që i bëhet vendimit nr.59, datë 27.9.2006, arrihet në përfundimin se Kuvendi nuk ka arritur të përcaktojë qartësisht dhe me të gjitha elementet kushtetuese objektin e hetimit të komisionit parlamentar, nga ku do të mund të ushtrohej ndikim i drejtpërdrejtë në realizimin e funksioneve parësore të legjislativit. Mbi këtë bazë, Gjykata Kushtetuese nxjerr konkluzionin se objekti i hetimit, ashtu siç parashikohet në këtë vendim të Kuvendit, nuk përputhet me funksionin dhe qëllimet e kontrollit parlamentar.

Duke paraqitur të njëjtat argumente, Gjykata Kushtetuese do të vlerësonte papajtueshmërinë kushtetuese edhe të objektit të komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e lidhjeve nepotike, konfliktin e interesit dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin prej tyre për Kryeministrin, familjarët dhe të afërmit e tij, nismë e cila nuk është refuzuar nga Kuvendi për

<sup>1</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 14.5.2003, Vendime të Gjykatës Kushtetuese 2003, faqe 84.

motivet kushtetuese të sipërcituara, por për një arsye antikushtetuese. Prandaj, shfuqizimi nga Gjykata Kushtetuese i vendimit nr.60, datë 27.9.2006 të Kuvendit, nuk ligjëron të drejtën e pakicës parlamentare që me të njëjtin objekt hetimi të kërkojë ngritjen e këtij komisioni parlamentar. Është detyrë e Kuvendit, ashtu si edhe e pakicës parlamentare, që në ndërmarrjen e nismave për ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare të kenë si orientim kryesor respektimin e parimeve kushtetuese, si dhe të qëndrimeve të mbajtura në jurisprudencën e kësaj Gjykate.

Mbështetur në argumentet e nxjerra nga kjo analizë, si edhe duke ballafaquar objektin e hetimit parlamentar me standardet dhe parimet kushtetuese të trajtuara gjerësisht në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese konkludon se:

- e drejta e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor nuk mund të mohohet, të kufizohet apo të deformohet nëpërmjet vendimmarrjes së shumicës parlamentare;
- ngritja e komisionit hetimor prej shumicës parlamentare nuk duhet të ndalojë shprehimisht dhe as në mënyrë të nënkuptuar komisionin e kërkuar dhe të ngritur nga pakica parlamentare;
- shkak i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet subjekteve të sipërcituara duhet kërkuar te mohimi i kompetencës kushtetuese të pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor me argumentin jokushtetues të Kuvendit për ezaurimin e kësaj kërkesë;
- mosekzistenca e indicies dhe e shkakut të përligjur për argumentimin e konceptit kushtetues “*çështje e veçantë*” ka sjellë shtrirjen e skajshme të rrethit të subjekteve dhe të periudhës kohore të hetimit dhe për rrjedhojë, e ka bërë të paqartë e të papërcaktuar objektin e hetimit të komisionit parlamentar;
- deformimi i kompetencës kushtetuese të Kuvendit për të hetuar në fusha apo çështje që nuk i përkasin drejtpërdrejt funksionit të kontrollit parlamentar, ka dubluar, zëvendësuar apo shmangur veprimtarinë e institucioneve të pavarura në ushtrimin e kompetencave të tyre ligjore.

#### PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 77; 131 shkronja “ç”; 134, pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 54, 55, 56 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës të jo më pak se një të katërtës së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.
2. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës të krijuar ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Shqipërisë, duke konkluduar se e drejta e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor është një kompetencë kushtetuese dhe e detyrueshme për t’u respektuar dhe që nuk mund të cenohet nëpërmjet vendimmarrjes së shumicës parlamentare, me përjashtim të rasteve të mosrespektimit të parimeve kushtetuese.
3. Të deklarojë të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si shkak për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, vendimin nr.60, datë 27.9.2006 të Kuvendit të Shqipërisë.
4. Të deklarojë të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë objektin e hetimit në vendimin nr.59, datë 18.9.2006 të Kuvendit të Shqipërisë.
5. Rrëzimin e kërkesës të jo më pak se një të pestës së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë për mungesë të juridiksionit kushtetues.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468**  
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## **BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

<b>1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË</b>	
<b>2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR</b>	
<b>3. REGJISTRAT E NOTERISË</b>	
<b>4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:</b>	
1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) .....	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

### **Botime të reja**

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 8.5.2007  
 Doli nga shtypi më 9.5.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Grafon”  
 Tiranë, 2007

Çmimi 28 lekë